



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1136/8 prot.

Datë 05.06.2024

V E N D I M
Nr. 628/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.06.2024 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “EL-GJO 2006” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-00058-04-04-2024, me objekt “Blerje artikuj ushqimor për shkollën speciale “3 Dhjetori”, me fond limit 2,499,325.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër
- Ankimues:** Operatori ekonomik “EL-GJO 2006” SHPK, me NIPT J66902033R dhe adresë: Lagjja “Tre Heronjte”, Rruga “Pal Engjelli”, Zona Kadastrale 8593, nr. pasurie 10/630 4001.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Shkodër, me adresë: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 – Shkodër.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të

Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e ankimuesit janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesën me nr. 1136 prot., datë 08.06.2024, përmes shërbimit postar pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.04.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-00058-04-04-2024, me objekt “Blerje artikuj ushqimor për shkollën speciale “3 Dhjetori”, me fond limit 2,499,325.00 lekë, pa TVSH, zhvilluar më datë 18.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II.2. Në datën 18.04.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 24.04.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1-“EL-GJO 2006” SHPK	1,613,075	lekë	skualifikuar
2-“Sead SGS” SHPK	1,874,785	lekë	kualifikuar

II.3.1. Operatori ekonomik “EL-GJO 2006” SHPK, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

“1-Oferta juaj rezulton anomalisht e ulet ne baze te formules se percaktuar ne DST si me poshte: Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur. Oferta juaj eshte me e ulet se 25% e fondit limit prandaj bazuar ne ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 93,pika 5 ku thuhet: Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.

2- Martin Dede Vata subjekt mbeshtetes nuk rezulton i regjistruar ne regjistrin tregtar QKB ne kundershitim me LPP, I ndryshuar neni 84.”

II.4. Në datën 02.05.2024, është publikuar në SPE “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak”, për procedurën e prokurimit.

II.5. Në datën 08.05.2024, operatori ekonomik “EL-GJO 2006” SHPK, ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik me numër 1136 prot., ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike nga procedura e prokurimit objekt – ankimi, duke pretenduar: *“Në lidhje me skualifikimin për ofertë anomalisht te ulet duam te kerkojme shpjegime nese kjo procedurë ka nisur me urdhër prokurimi para dt 20 Mars apo pas saj, periudhe qe ka hyre ligji i ri per moskërkesën e shpjegimeve per oferten anomalisht te ulet, qe ne e kemi te justifikuar dhe kerkojme te na sqaroni sepse nuk na eshte kerkuar dokumenti justifikues.*

Ndersa per arsyen qe Martin Vata nuk eshte subjekt mbeshtetes, ligji nuk citon asgjekundi qe nuk lejohet qiramarrja mes individeve dhe firmave pjesemarrese ne procedura tenderimi per mjete me qera. Ne skualifikimet e meparshme ne jemi skualifikuar nga vete ky autoritet kontraktor sepse nuk kemi bere formularin e vetëdeklarimit te po ketij individi, por jo per arsyen se nuk eshte subjekt me NIPT.”

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr.1136/3 prot., datë 09.05.2024 lidhur me arsyet e skualifikimit të ankimuesit.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 10136 prot., datë 14.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 1136/5 prot., 16.05.2024 me lëndë “*Informacion*”, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimues nga ku rezulton, që autoriteti kontraktor ka hedhur poshtë pretendimet e ankimuesit duke refuzuar ankesën e tij. Sipas informacionit të autoritetit kontraktor, ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë tij, më datë 08.05.2024.

II.8. Në datën 08.05.2024, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4070 dhe me nr. 1136/1 prot., datë 09.05.2024 e operatorit ekonomik “EL-GJO 2006” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-00058-04-04-2024, me objekt “Blerje artikuj ushqimor për shkollën speciale “3 Dhjetori” me fond limit 2,499,325.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II.9. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr.1136/4 prot., datë 09.05.2024, lidhur me arsyet e skualifikimit të ankimuesit.

II.10. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “EL-GJO 2006” SHPK me nr. 1136 prot., datë 08.05.2024, të paraqitur përmes shërbimit postar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe njëherazi pranë autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se urdhri i prokurimit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi mban nr. 449 dhe datën 29.03.2024.

III.1.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesën me nr. 1136 prot., datë 08.05.2024, përmes shërbimit postar pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.3. Në nenin 111 “Paraqitja e ankesës”, pika 1, paragrafi i parë të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohet se: *“Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.”*

III.1.4. Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.*

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme:

a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in;

b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).”

III.1.5. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar ndryshimeve të fundit të ligjit për prokurimin publik të cilat gjejnë rregullim në ligjin nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 ‘Për prokurimin publik’” miratuar më datë 08.02.2024, botuar në fletoren zyrtare me nr. 40, me datë publikimi në fletoren zyrtare 03.04.2024, dhe hyrë në fuqi me datë 20.03.2024, çdo ankesë e operatorëve ekonomikë pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore, duhet dërguar njëkohësisht në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Në rastin konkret, referuar verifikimeve në sistemin e ankesave elektronike, si dhe materialeve në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezulton, se ankesa e operatorit ekonomik ankimues me nr. 1136 prot., datë 08.05.2024, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik dhe në autoritet kontraktor përmes shërbimit postar në kundërshtim me parashikimet e nenit 111 paragrafi i parë i ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Në rastin konkret, referuar dokumentacionit të administruar dhe verifikimeve në sistemin e ankesave elektronike, rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të

Prokurimit Publik me datë 08.05.2024 përmes shërbimit postar, ndërkohë që bazuar në ndryshimet e fundit ligjore (hyrë në fuyqi me datë 20.03.2024), në datën kur ai ka paraqitur ankesën (me 08.05.2024), ajo duhej dërguar njëkohësisht në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik vetëm përmes Sistemit të Ankesave Elektronike. Në këtë kuptim KPP gjykon, se ankesa e depozituar në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik përmes shërbimit postar më datë 08.05.2024, konsiderohet e paraqitur në kundërshtim me parashikimet e nenit 111, pika 1, paragrafi i parë i ligjit 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duke mos respektuar kështu rrugën për paraqitjen e ankesës.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa me nr. 1136 prot., datë 08.05.2024, e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues në KPP dhe autoritet kontraktor përmes shërbimit postar, nuk kanë përmbushur detyrimin për ndjekjen e rrugës ligjore për paraqitjen e ankesës sipas parashikimeve të nenit 111, pika 1, paragrafi i parë i ligjit 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik, rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve dhe i rrugës për paraqitjen e ankesës pas ndryshimeve të fundit ligjore, është i një rëndësie thelbësore, e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Sa më sipër, ankesa me nr.1136 prot., datë 08.05.2024, e operatorit ekonomik “EL-GJO 2006” SHPK, nuk pranohet.

III.2. Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “EL-GJO 2006” SHPK, me datë 08.05.2024, me numër ankimi elektronik A/2024/4070 dhe me nr. 1136/1 prot., datë 09.05.2024, para shqyrtimit në themel të saj, KPP gjen me vend të sqarojë se kjo ankesë lidhet me procedurën e prokurimit të sipërcituar dhe për të njëjtat arsye skualifikimi si në ankesën me nr. 1136 prot., datë 08.05.2024, të paraqitur në KPP nga ankimuesi përmes shërbimit postar, por ai i ka bashkëlidhur dosjes së ankesës me nr. 1136/1 prot., të dërguar përmes sistemit të ankesave elektronike, të njëjtin mandat - pagesë që i përket ankesës me nr. 1136, datë 08.05.2024, dhe statusi i pagesës për ankesën me nr. 1136/1 prot., rezulton “pa paraqitur”. Në këtë kuadër, duke qenë se ankesa e paraqitur në sistemin e ankesave elektronike më datë 08.05.2024, me numër ankimi elektronik A/2024/4070 dhe me nr.1136/1 prot., datë 09.05.2024, është paraqitur nga i njëjti operator ekonomik, për të njëjtën procedurë prokurimi dhe për të njëjtat arsye skualifikimi, KPP do të konsiderojë si mandate - pagesë atë të ankesës me nr.1136 prot., date 08.05.2024, e cila nuk u pranua nga KPP për shkak të mosezaurimit të rrugës së duhur ligjore për paraqitjen e ankesës, duke konsideruar tashmë edhe statusin e pagesës për ankesën me numër ankimi elektronik A/2024/4070 datë 08.05.2024 dhe me nr.1136/1 prot., datë 09.05.2024, si të paguar.

III.3. Lidhur me skuafikimin e operatorit ekonomik “EL-GJO 2006” SHPK nga procedura e prokurimit me arsyen se : “*1- Oferta juaj rezulton anomalisht e ulet ne baze te formules se percaktuar ne DST si me poshte: Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më*

shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur. Oferta juaj është me e ulët se 25% e fondit limit prandaj bazuar në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” I ndryshuar, neni 93, pika 5 ku thuhet: Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët”, KPP vëren se,

III.3.1. Në nenin 93 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”

III.3.2. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.
- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.3.3. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “EL-GJO 2006” SHPK, si edhe nga përllogaritjet e kryera, konstatohet, se oferta ekonomike në vlerën prej 1,613,075.00 lekë pa TVSh, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 dhe 5 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim. Mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit.

Në rastin konkret, në zbatim të pikës 5, të nenit 93 të LPP-së se: *në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët*”, procedura e prokurimit objekt - shqyrtimi e ka fondin limit 2,499,325.00 lekë, vlerë e cila rezulton nën kufirin e lartë monetar, referuar nenit 11 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku thuhet se: *Në përputhje me nenin 33, të LPP-së, kufijtë monetarë janë:*

a) *Kufiri i lartë monetar:*

- 650 000 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;
- 40 000 000 (dyzet milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

b) *Kufiri i ulët monetar:*

- 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;
- 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se vendimi i KVO-së për refuzimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “EL-GJO 2006” SHPK është i drejtë, pasi ndryshimet e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kanë hyrë në fuqi më datë 20.03.2024, ndërkohë që urdhri i prokurimit për procedurën e mësipëme të prokurimit mban datën 29.03.2024, ndaj për procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, siç

është rasti në fjalë, autoriteti kontraktor e refuzon ofertën e cila është konstatuar anomalisht e ulët pa kërkuar shpjegime.

Sa më lart pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.4. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “2- *Martin Dede Vata subjekt mbështetes nuk rezulton i rregjistruar ne rregjistrin tregtar QKB ne kundërshtim me LPP I ndryshuar neni 84.*” KPP vëren se,

III.4.1. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur në SPE, operatori ekonomik “EL- GJO 2006” SHPK në seksionin “Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të cilëve do të mbështetet ka deklaruar:

. Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et
Qeradhenes Individi Martin Dede Vata	ID G0010307 2U	Mjet transporti ATP (frigorifer)	ATP me kapacitet mbajtes ngarkese 655T me nr leje qarkullimi SHD0710220

III.4.2. Në nenin 82, “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*” të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikohet:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të

vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.”

III.4.3. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet:

1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.

2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.

3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij.

Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.

5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.

6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.

7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”

III.4.4. Në nenin 2 “Përkufizime” pika 13 e ligjit nr. Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, parashikohet: “13. “Subjekt tregtar” është personi fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil, që ka cilësinë e tregtarit, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, shoqëritë tregtare dhe degët e shoqërive të huaja.”

III.4.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.4.6. Në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;

- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.

- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilin e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.

- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit.

Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.”

III.4.7. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.4.8. Refruar arsyes së skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, pretendimeve të ankimuesit dhe materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, KPP konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku në Pjesa I, pika B, është dhënë informacion mbi subjektet, mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik “EL-GJO 2006” SHPK. Konkretisht sipas deklarimeve ai do të mbështetet mbi kapacitetet e individit Martin Dedë Vata, për sa i përket automjetit të llojit ATP me kapacitet mbajtës ngarkese 655T me nr. leje qarkullimi SHD0710220. Komisioni gjykon, se referuar

nenit 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh tek një operator ekonomik, konkretisht parashikohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Ndërsa në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se 1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së. 2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; - t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme; - t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së; - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor. Në Nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht, se për pikën 1, të nenit 76, të Ligjit “Për Prokurimin Publik”, nga ana e operatorit ekonomik duhet të plotësohet formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe në rregullat e prokurimit publik. Referuar dokumenteve të tenderit, në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, në pjesën e fundit përcaktohet, se, “në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës”. Në procedurën objekt-shqyrtimi, operatori ekonomik ankimues “EL-Gjo 2006” SHPK, ka deklaruar si një nga subjektet në kapacitetet e të cilit do të mbështetet, individin Martin Dedë Vata, ku përveç Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të tij, ka paraqitur edhe Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të Martin Vata si subjekt mbështetës, si dhe një kontratë qiraje me nr. Rep 723 dhe nr. Kol 401, e datës 08.03.2021, e lidhur mes subjektit mbështetës Martin Vata dhe ankimuesit “EL-Gjo 2006” SHPK, për dhënien me qira të automjetit ATP, i markës Fiat, me nr. Shasie ZFA22300005598262. Duke u bazuar në arsyen e skualifikimit të ankimuesit, KPP e gjykon të drejtë vendimin e

autoritetit kontraktor sepse ankimuesi ka deklaruar si subjekt mbështetës *individ* “Martin Dedë Vata” me nr. ID G00103072U, dhe jo me NIPT, siç edhe rubrika perkatëse *“Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik”* e kërkon. Fakti që rubrika perkatëse në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për subjektin mbështetës ka përcaktuar NIPT-in dhe jo dokument identifikimi të individit (ID) tregon që subjektet mbështetëse duhet t’i nënshtrohen një regjimi juridik të posaçëm, atij të “subjektit tregtar”, në kuptim të nenit 2 pika 13 të ligjit nr. 9723, datë 3.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, në të cilin përcaktohet se: *“Subjekti tregtar” është personi fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil, që ka cilësinë e tregtarit, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, shoqëritë tregtare dhe degët e shoqërive të huaja.*” Duke iu nënshtuar këtij regjimi juridik (si subjekt tregtar në cilësinë e personit fizik apo juridik), sipas parashikimeve të ligjit të sipërcituar, janë të detyruar të regjistrohen në regjistrin tregar, si një bazë të dhënash unike që përmban të dhëna të subjektit që ka detyrimin të regjistrohen, ndër të cilat përfshihet edhe NIPT-ti. Duke e parë në këtë këndvështrim, KPP gjykon, se si subjekt mbështetës nuk mund të deklarohet një individ por një subjekt tregtar në cilësinë e personit fizik apo juridik, i regjistruar në regjistrat tregtar sipas legjislacionit sektorial në fuqi dhe i pajisur me një numër identifikimi si person i tatueshëm (NIPT).

Sa më lart, pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesat e operatorit ekonomik “EL- GJO 2006” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-00058-04-04-2024, me objekt “Blerje artikuj ushqimor për shkollën speciale ‘3 Dhjetori’” me fond limit 2,499,325.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “EL- GJO 2006” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

